



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë: 14.12.2021

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “INA” sh.p.k, me NUIS J61814009W, me adresë: rruga “Besim Imami”, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-10470-11-05-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rehabilitim i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit Gjyslikonjë”, me afat zbatimi 45 (dyzet e pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës, fond limit 37.675.320 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëzet) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 163, datë 15.11.2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “INA” sh.p.k me NUIS J61814009W, me adresë: rruga “Besim Imami”, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit, Tiranë dhe me ofertë ekonomike **33.215.460** (tridhjetë e tre milion e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh.
2. “Shendelli” sh.p.k, me NUIS K07924803N, me adresë: Lagjja "Kastrioti", rruga "Andon Profka", 2 kullat Fier dhe me ofertë ekonomike **32.281.045** (tridhjetë e dy milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e dyzet e pesë) lekë pa tvsh.
3. “XHENGO” sh.p.k, me NUIS J64103171M, me adresë: DON. GJON. BUZUKU, L.5, Korçë dhe me ofertë ekonomike **35.714.740** (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e katërmëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “**Shendelli**” sh.p.k, me NUIS K07924803N,
2. “**XHENGO**” sh.p.k, me NUIS J64103171M

Për arsytet e mëposhtme:

“**Shendelli**” sh.p.k

1. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme), lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik 2021-shtator 2021 si më poshtë:*

*4 (katër) punonjës mekanik
4 (kater) punonjës hekurkthyes
4 (kater) punonjës karpentier
4 (kater) punonjës saldator*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi ka verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ka konstatuar se dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik për punonjësit e mëposhtëm kanë si datë fillimi të vlefshmërisë së tyre datat si mëposhtë vijon:

Nebi Lezaj	mekanik	07.12.2021
Vasillaq Vruho	mekanik	07.12.2021
Avdul Kamberaj	hekurkthyes	07.12.2021
Vitor Prenga	hekurkthyes	25.11.2021
Klodian Hoxha	karpentier	07.12.2021
Ervin Hoxhaj	karpentier	07.12.2021
Vladimir Noku	saldator	06.12.2021
Kastriot Topollaj	saldator	07.12.2021
Ndre Tanushi	saldator	07.12.2021

Afati i fundit për pranimin e ofertave dhe data e zhvillimit të tenderit ka qenë data 23.11.2021. Duke qenë se data e fillimit të vlefshmërisë së dëshmimeve të kualifikimit të

sigurimit teknik është pas datës së tenderit, rezulton se këta punonjës nuk kanë qenë të pajisur me dëshmitë e kërkuara në këtë datë.

“XHENGO” sh.p.k

1. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme), lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën korrik 2021- shtator 2021 si më poshtë:*

*4 (katër) punonjës mekanik
4 (kater) punonjës hekurkthyes
4 (kater) punonjës karpentier
4 (kater) punonjës saldator*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi ka verifikuar dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik për stafin teknik ka konstatuar se nuk plotëson numrin e kërkuar sipas kërkesës së mësipërme. Konkretisht ka paraqitur 3 karpentier, 2 hekurkthyes, 1 saldator dhe 1 mekanik.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin “INA” sh.p.k, me NUIS J61814009W, me adresë: rruga “Besim Imami”, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **33.215.460** (tridhjetë e tre milion e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferte e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.